EFIÇIENCA E ENERGJISË NË NDËRTESA PUBLIKE NË PRIZREN

Shteti:	KOSOVA
Numri i projektit:	51898
Sektori i biznesit:	Infra Europe
Lloji i njoftimit:	STATE
Kategoria mjedisore:	B
Data e synuar aprovimit:	14 prill 2021
Statusi:	Në pritje për miratim
DPP e shpalosur:	21 dhjetor 2020

Përshkrimi i projektit

Dhënia e një huaje senior deri në 5 milion Euro për Komunën e Prizrenit (“Komuna” ose “Prizreni”), e strukturuar si obligim direkt komunal për qytetin për t’i bashkëfinancuar masat e efiçiencës së energjisë (“EE”) në ndërtesat në pronësi të Komunës, përfshirë kopshtet e fëmijëve, shkollat dhe qendrat e kujdesit shëndetësor primar (“projekti”).

Projekti do të bashkëfinancohet me një grant investimi nga Programi Rajonal i Efiçiencës së Energjisë për Ballkanin Perëndimor (“REEP”) i financuar nga Bashkimi Evropian.

Objektivat e projektit

- Përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore të ndërtesave në pronësi komunale në Prizren duke implementuar masat EE që do të çojnë në kursimin e energjisë dhe uljen e emetimeve të CO2.
- Përmirësimi i performancës energjetike të ndërtesave të rinovuara nga të paktën dy klasa të Certifikatës së Performancës së Energjisë (“EPC”).
- Përmirësimi i niveleve të komoditetit dhe cilësisë në ndërtesat e rinovuara, gjë që është shumë e rëndësishme për ndërtesat e kësaj natyre (fëmijët dhe kujdesi shëndetësor).

Ndikimi i tranzicionit

ETI 65

Caku kryesor i projektit është arritja e përmirësimeve të rëndësishme mjedisore dhe promovimi i tranzicionit të ekonomisë së gjelbër ("GET") brenda Komunës. Projekti do të prezantojë cilësi të larta, teknologji inovative të EE në ndërtesa që do të kenë efekt të fortë demonstrimi dhe do të përkrahin "valën e rinovimit" të ndërtesave në tërë vendin dhe në rajon. Për më tepër, struktura e financimit të huasë si huazimi i parë i drejtpërdrejtë nga Komuna, dhe si projekti i dytë i sektorit publik nën-sovran në Kosovë, promovon cilësinë e tranzicionit rezilient duke zgjeruar gamën e instrumenteve të financimit në dispozicion.

Informatat për klientin

KOMUNA E PRIZRENIT

Prizreni është komuna e dytë më e madhe në Kosovë dhe qendra rajonale e Kosovës Jugperëndimore me popullsi prej afro 180.000 banorë.

Përmbledhje e financimit nga BERZH

5,000,000.00 €

Hua nën-sovrane deri në 5 milionë €.

Kostoja totale e projektit

7,100,000.00 €

Kostoja totale e parashikuar e projektit është afërsisht 7,5 milionë euro përfshirë Asistencën Teknike.

Përmbledhje Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar B (2019 PMS). Ky projekt do të ketë përfitime të konsiderueshme në lidhje me masat e efiçiencës së energjisë me cilësi të lartë, përfshirë përmirësimin e izolimit të ndërtesës dhe zëvendësimin e burimeve të vjetra të ngrohjes, duke rezultuar në përmirësimin e efiçiencës së energjisë së ndërtesat publike në qytetin e Prizrenit dhe uljen e emetimeve prej tyre. Kujdesi i Duhur Mjedisor dhe Social (KDMS) përfshiu një auditim të kryer nga një konsulent i pavarur, si dhe vizitën në terren në 11 ndërtesa të përzgjedhura. KDMS-ja konstatoi se Komuna ka disa elementë të kufizuar të menaxhimit mjedisor dhe social dhe se është përgjithësisht në përputhje me legjislacionin kombëtar. PVMS-ja është përgatitur dhe dakorduar me Komunën.

Projekti konsiston në zbatimin e masave të efiçiencës së energjisë (EE), strukturore dhe të komoditetit në deri 100 ndërtesa në pronësi të komunës, të tilla si kopshte fëmijësh, shkolla dhe qendra të kujdesit parësor shëndetësor. Këto masa të EE-së do të gjenerojnë kursime vjetore të energjisë prej rreth 59%, dhe do të shmangin 42% të emetimeve vjetore të CO_2 (ekuivalente me 275 ton emetime CO_2 në vit). Gjetjet teknike dhe të KDMS-së treguan se për disa ndërtesa, uji i furnizuar nuk i plotëson standardet e ujit të pijshëm, lokacionet nuk janë të lidhura me sistemin e ujërave të zeza, dhe disa shkolla nuk janë të pajisura me tualete të përshtatshme. Prandaj, në fushëveprimin e projektit janë shtuar masa esenciale strukturore dhe të komoditetit; ato përfshijnë përmirësimin e strukturave të dëmtuara, sistemet e ujërave të zeza/kullimit, hidroizolimin, heqjen e azbestit, dhomat sanitare, etj. Komuna nuk ka një politikë për MS dhe as nuk operon një Sistem për Menaxhim Mjedisor, Shëndetësor, të Sigurisë dhe Social (MSHSN). PVMS-ja kërkon që klienti t'ia caktojë përgjegjësi për menaxhimin e MSHSN-së Njësisë për Zbatimin e Projektit, dhe të caktojë një Menaxher të certifikuar për MSHS me orar të plotë në kuadër të Komunës.

Kontraktori do të zhvillojë dhe zbatojë një Plan të Menaxhimit Mjedisor, Shëndetësor, të Sigurisë dhe Social për Fazën e Ndërtimit (PMMSHSN), i cili do të aprovohet nga Komuna para fillimit të ndërtimit. PVMS-ja kërkon që Komuna të sigurojë që në çdo ndërtesë të Projektit, i) përdoruesit e ndërtesës të kenë qasje në ujë të pijshëm, ii) përdoruesit e ndërtesës të kenë qasje në tualetet e vendosura brenda ndërtesës dhe të pajisur me ujë të rrjedhshëm për shkarkim, iii) ujërat e zeza shtëpiake të mblidhen dhe trajtohen para shkarkimi në mjedisin natyror.

Të gjitha kontratat janë në përputhje me Ligjin e Punës. Stafi i Komunës është i mbuluar nga një Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive e Punësimit dhe një përqindje e lartë e të punësuarve janë anëtarë të një sindikate. Tani për tani nuk ka asnjë program shkurtimesh madhore të planifikuar për mbarë Komunën. Shumica e ndërtesave ngrohen me kaldaja moderne qendrore me pelet ose kaldaja me dru zjarri të teknologjisë moderne (ose me energji elektrike); për ndërtesat e lidhura me projektin që ngrohen me shporete individuale me dru zjarri dhe jo të certifikuara, PVMS-ja kërkon zëvendësimin me sisteme të ngrohjes që janë më pak ndotëse të ajrit. Çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë në shumicën e lokacioneve të vizituara gjatë KDMS-së, kanë nevojë për menaxhim të përmirësuar; veprimet korrigjuese operacionale janë paraqitur në PVMS. PVMS-ja kërkon që të bëhet një anketë intruzive për azbest dhe, kur të identifikohet azbest, të zbatohen masat e nevojshme për të zvogëluar risqet e ekspozimit ndaj fibrave të azbestit. Anketat për asbest do të kryhen së bashku me auditimet e energjisë në çdo ndërtesë të Projektit, dhe është vendosur obligimi për zbatimin e një Plani të Menaxhimit të Azbestit. Izolimi termik i mureve dhe kulmeve do të vlerësohet siç duhet nga furnizuesi në lidhje me shkallën e rezistencën ndaj zjarrit, siç përcaktohet në standardet kombëtare. PVMS-ja kërkon që inxhinieri i dizajnit të dorëzojë një raport të sigurisë nga zjarri në Komunë, dhe që çështjet operative të SSHP-së të adresohen pas përfundimit të punimeve (aparate për fikjen e zjarrit, dyer të sigurisë nga zjarri, etj.). Të gjitha ndërtesat janë në pronësi të Komunës dhe menaxhohen prej saj, megjithatë në disa raste parcelat e tokës kontestohen nga pronarë privatë. PVMS-ja kërkon që Komuna të sigurojë dokumentet e munguara të pronësisë. Asnjë nga ndërtesat e Projektit nuk është në listën e ndërtesave që janë nën mbrojtje nga UNESCO ose ligji kombëtar (siç konfirmohet nga një dispozitë në Marrëveshjen e Kredisë). Komuna mban ueb faqen e vet zyrtare. Mekanizmi për ankesa online është tashmë i vendosur. Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI) është hartuar gjatë KDMS-së; komuna do t'i njoftojë paraprakisht përdoruesit e ndërtesave për aktivitetet e planifikuara të rindërtimit duke përfshirë qasjen alternative në shërbimet e ndërprera (p.sh. pacientët që do të dërgohen përkohësisht në objekte të tjera të kujdesit shëndetësor).

Banka do ta monitorojë projektin përmes raporteve vjetore mjedisore dhe sociale të dorëzuara nga Klienti, dhe përmes vizitave në terren nëse është e nevojshme.

Bashkëpunimi teknik

- Studimi i Fizibilitetit të Projektit
- Kujdesi i duhur mjedisor dhe social
- Përkrahja për implementimin e projektit

Përveç kësaj

- Struktura e Financimit - BERZH do ta jep huanë e parë të drejtpërdrejtë për Komunën dhe ky është projekti i dytë nën-sovran i sektorit publik në Kosovë.

- Zbutja e riskut - Investimi i propozuar do të rezultojë në kursime të energjisë dhe emetim më të ulët të gazrave serrë, duke ulur kështu risqet jo-financiare dhe të tranzicionit të karbonit.
- Vendosja e standardit - Asistenca teknike dhe kushtet e huasë do ta përkrahin ndërtimin e kapaciteteve.

Informatat kontaktuese të kompanisë

Arianit Blakaj
blakaja@ebrd.com
+38345270300

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni këtu.

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:
Tel: +44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH-it.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t’i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në PMS.

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin

e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt. OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës së Qasjes në Informacion për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.
Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH.

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .
MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale apo dispozitat specifike për Projektin të Politikës së Qasjes në Informacion; dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjsinë ndaj Projektit për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të dërguar një kërkesë për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.